

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl - Kzz 61/2011

10 tetor 2011

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit dhe gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia dhe gjyqtares së Gjykatës Supreme Nesrin Lushta si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore Rojek si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër të Pandehurit Tomë Gashi, emri i babait Viktor, i lindur më 14 gusht 1961, me vendbanim në Prishtinë, rruga Luan Haradinaj nr. 15, shtetas i Kosovës me kombësi shqiptare,

I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 514/09 të Gjykatës Komunale të Prishtinës të datës 28 maj 2010, për veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas nenit 317 paragrafit 2 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), me dënim me kusht prej 6 (gjashtë) muajve burgim sipas neneve 43, 44 dhe 317 paragrafin 2 të KPK-së,


I konfirmuar me aktgjykimin AP nr. 395/10 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 9 dhjetor 2010, duke e refuzuar ankesën e të pandehurit kundër aktgjykimit të shkallës së parë,

Duke vepruar lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i pandehurit Tomë Gashi më 26 prill 2011 kundër aktgjykimit P nr. 514/09 të Gjykatës Komunale në Prishtinë të datës 28 maj 2010 dhe aktgjykimit AP nr. 395/10 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 9 dhjetor 2010, dhe duke e pasur parasysh Përgjigjen e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) lidhur me Kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës Supreme të Kosovës në 1 gusht 2011,

Pas mbajtjes së seancës dhe këshillimit më 10 tetor 2011, sipas neneve 454 paragrafit 1 dhe 456 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), lëshon këtë,

### AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga i pandehuri Tomë Gashi më 26 prill 2011 kundër aktgjykimit P nr. 514/09 të Gjykatës Komunale të Prishtinës të datës 28 maj 2010 dhe aktgjykimit AP nr. 395/10 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 9 dhjetor 2010, **REFUZOHET**.



## ARSYETIM

### *I. Historia procedurale e procedurës penale*

Më 19 janar 2007, Prokurori Publik Komunal ka paraqitur aktakuzën Pp.nr. 3695-14/06 duke e akuzuar të pandehurin dhe tre individë të tjerë për veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në kundërshtim të nenit 317 paragrafit 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (sa i përket Tomë Gashit), Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në kundërshtim të nenit 316 paragrafit 3 në lidhje me paragrafin 1 dhe nenin 23 të KPK-së (sa i përket të pandehurit të dytë dhe të tretë), dhe Lëndimi i lehtë trupor në kundërshtim të nenit 153 paragrafit 2 në lidhje me paragrafin 1, pikën 4 të KPK-së (sa i përket të pandehurit të katërt).


Më 10 mars 2008, pas shqyrtimit aktakuza PP nr. 3695-14/09 është konfirmuar në tërësi

Më 19 mars 2009, Kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që gjykimi kundër të pandehurit Tomë Gashi të transferohet në ndonjë Gjykatë tjetër pasi që Tomë Gashi ka qenë Gjyqtar në këtë Gjykatë Komunale dhe aktualisht ka qenë avokat në këtë gjykatë. Lënda i është deleguar Gjykatës Komunale të Ferizajt më 27 prill 2009. Më 26 qershor 2009, Kryetari i Gjykatës Komunale të Ferizajt ka kërkuar nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (KAGjE-së) që të caktojë gjyqtarë të EULEX-it në këtë lëndë, duke e pasur parasysh pozitën e Tomë Gashit si Këshilltar i Zyrës së Kryeministrit dhe keqpërdorimit potencial të drejtësisë. Më 17 shtator 2009, KAGjE-së ka vendosur që lënda t'i caktohet gjyqtarëve të EULEX-it.

Gjykimi ka filluar më 14 maj. Më 28 maj 2010, Prokurori Publik Komunal ka ndryshuar cilësimin e veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas nenit 376 paragrafit 1 të KPPK-së. Ai ka ndryshuar paragrafët e referuar 1 dhe 2 të nenit 317 duke e shtuar paragrafin 4 të të njëjtit nen. Pas pushimit, i pandehuri ka pranuar fajësinë për Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas cilësimit të ri të veprës penale të dorëzuar nga Prokurori.<sup>1</sup>

Më 28 maj 2010, Gjykata Komunale e Prishtinës ka shpallur të pandehurin Tomë Gashin fajtor për veprat penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas nenit 317 paragrafit 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, me përjashtim të rrethanës nga paragrafi 4. Sepse më 26 tetor 2006, rreth orës 03:30 në Prishtinë, në lagjen dardania, rrugën Bill Clinton në hotel-barin "Route 66", ai ka sulmuar një Polic të Kosovës, palën e dëmtuar Lulzim Borovcin përderisa ky i fundit ishte duke i kryer detyrat e tij zyrtare të mbajtjes së sigurisë publike, në atë mënyrë që, pasi që i pandehuri Tomë Gashi dhe dy të tjerë kanë hyrë në barin e lartpërmendur dhe si rezultat i sjelljes së keqe ndaj konsumatorëve të tjerë të pranishëm në bar, fillimisht një zënkë me fjalë dhe pastaj në mes tyre ka filluar përleshja fizike. Me atë rast ka intervnuar Policia dhe gjersa mundoheshin që t'i ndajnë dhe ndalojnë individët, i pandehuri reagoi në mënyrë të vrazhdët duke sharë, kërcënuar dhe fyer dhe e sulmoi fizikisht Lulzim Borovcin, kapt

<sup>1</sup> Shih aktgjykimin P. Nr. 514/09 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, 28 maj 2010, faqet 1-3.



pjesën e epërme të uniformës së tij dhe e goditi atë me dorën e djathtë në fytyrë afër syrit të majtë, dhe i pandehuri i rezistoi prangosjes duke i mbërthyer dhe shtyrë policët me duart e tij, dhe gjatë këtyre veprimeve ata ranë përtokë, si pasojë e kësaj Lulzim Borovci pësoi lëndime të cilësuar si lëndime të lehta trupore që rezultuan me dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Gjykata Komunale e Prishtinës e dënoi të pandehurin me kusht me gjashtë (6) muaj burgim në përputhje me Nenin 317 Paragrafin 2, 43 dhe 44 të KPK-së, me kusht që dënimi nuk do të ekzekutohet nëse Tomë Gashi nuk kryen asnjë veprë tjetër penale për një periudhë një (1) vjeçare. Trupi gjykues po ashtu urdhëroi të pandehurin t'i paguajë shpenzimet e procedurës të caktuara në shumën 50.00 euro, në përputhje me Nenin 102 Paragrafin 1 të KPPK-së.

Më 9 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin AP nr. 395/10, refuzoi Ankesën e paraqitur nga Tomë Gashi më 30 shtator si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë.

Më 26 prill 2011, i pandehuri Tomë Gashi paraqiti një Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit P Nr. 514/09 të Gjykatës Komunale të Prishtinës të datës 28 maj 2010 dhe aktgjykimit AP nr. 395/10 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 9 dhjetor 2010. Më 1 gusht 2011, ZPShK-ja paraqiti Përgjigje ndaj Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

## ***II. Parashtrirat e palëve***

*Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga i pandehuri Tomë Gashi*

I pandehuri pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga Neni 403 paragrafi 1 i KPPK-së dhe nga Neni 451 paragrafi 1 pika 3 e KPPK-së dhe në shkelje të ligjit penal. Për këto arsye, ai propozon Gjykatës Supreme të Kosovës t'i anulohet të dyja aktgjykimet e kundërshtuara dhe ta kthejë lëndën në shkallë të parë për rigjykim ose rivendosje.

Ai pretendon se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale nga Neni 403 paragrafi 1 pika 10 e KPPK-së sepse aktgjykimet e kundërshtuara tejkalojnë akuzat e prokurorisë. Kjo duhet të lexohet lidhur me Nenin 386 paragrafin 1 të KPPK-së. Ai mendon se aktakuza ishte ndryshuar në favorin e tij gjatë seancës së gjykimin dhe kjo rrethanë është dashur të merrej parasysh nga gjykatës e shkallës së parë. Përveç kësaj i pandehuri pohon se dyshimet përkitazi me ekzistimin e një fakti përkatës për lëndën duhet të interpretohen në favorin e të akuzuarit në përputhje me Nenin 3 të KPPK-së.

Ai po ashtu pohon se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga Neni 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK-së pasi që dispozitivi është i pakuptueshëm dhe kundërthënës me arsyet e aktgjykimit. Përveç kësaj arsyetimit nuk i përmend faktet vendimtare dhe ekziston një kundërshtim në mes arsyetimit dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës.



I pandehuri pretendon se Gjykata Komunale 'ka shpikur një hotel-bar Route 66' dhe e ka lënë të paqartë nëse lëndimet e palës së dëmtuar janë shkaktuar nga ai. Ai po ashtu debaton se një varg i dëshmimeve të dëshmitarëve të përmendura në dispozitiv ish-in marrë në kundërshtim me Nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së pasi që atij asnjëherë nuk iu dha mundësia për t'i kundërshtuar këto dëshmi.

I pandehuri pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga Neni 403 paragrafi 2 pika 1 dhe 2 e KPPK-së me moslejimin e të pandehurit të paraqesë lëndën e tij.

Në fund ai pretendon se gjykata nuk arriti t'i marrë parasysh faktet e vërtetueshme: Ekspertiza përkitazi me lëndimet e policit Lulzim Borovci nuk ishte e saktë dhe nuk është dashur të përdorej si dëshmi nga gjykata (shkelje e Nenit 403 Paragrafit 2 Pika 1 e KPPK-së); Lulzim Borovci kishte shkuar në klinikën e Urgjencës në orën 10.30 më 26 tetor 2006, edhe pse sulmi kinse ka ndodhur në 3.30; ky i fundit kishte deklaruar se Tomë Gashi ia theu syzet gjatë sulmit, kurse fotografia e tij me syzet e njëjta, të padëmtuara, ishte bërë nga policia dhe Prokuroria dhe gjykata refuzuan në mënyrë të paligjshme propozimin e mbrojtjes për ekzaminimin e syzeve; me pretendim se polici kishte të veshur uniformën e verës në fund të tetorit 2011; Tomë Gashi konteston gjendjen e tij alkoolike në kohën përkatëse dhe thekson se policët nuk kanë bërë asnjë alkool test; ai më tuje faktin se rrobat e tij nuk janë dëmtuar fare edhe pse siç supozohet ai është përleshur me policin nga afër; në fund gjykata kishte lëshuar paligjshëm një mendim individual të portretit psiko-social të të pandehurit.

Ai pretendon se vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike rezultoi me shkeljen e ligjit penal.

#### *Përgjigja e ZPShK-së ndaj Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë*


Në përgjigjen e vet, ZPShK-ja i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta pranojë Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër të dy aktgjyqimeve të kundërshtuara. Ai pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk është në pajtim me cilësimin juridik të veprës penale të përfshirë në aktakuzën e ndryshuar dhe shpalli të pandehurin fajtor për veprë penale në përputhje me Nenin 317 paragrafin 2 të KPPK-së, pra për një veprë më të rëndë penale.

ZPShK-ja është e mendimit se liria e veprimit përkitazi me cilësimin juridik sipas Nenit 386 paragrafit 2 të KPPK-së mund të aplikohet vetëm në favor të të akuzuarit por jo në dëm të tij/saj. Prandaj ZPShK-ja përfundon se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë shkelur dispozitat e Nenit 403 paragrafit 1 pika 10 lidhur me Nenin 386 paragrafin 1 dhe Nenin 3 paragrafin 2 të KPPK-së.

### **III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

#### *III. A. Lejueshmëria e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë*

Kërkesa është lejueshme.



Pretendohet se kërkesa është paraqitur brenda afatit prej tre muajsh i cili përcaktohet me nenin 452, par. 3 të KPPK-së edhe pse shkresat e lëndës nuk përmbajnë dëftesat të cilat vërtetojnë dorëzimin e aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Për t'iu shmangur pengesave procedurale për të pandehurin, mungesa e provave duhet të interpretohet për të mirën e tij, duke konstatuar se i njëjti kishte pranuar aktgjykimin më 27 janar 2011.

Kërkesa ka të bëjë me vendimin gjyqësor të formës së prerë në kuptim të Nenit 451, par. 1 të KPPK-së. Gjykata e Qarkut ka vepruar si gjykatë e shkallës së dytë kështu që janë shtjerrë mjetet e tjera të rregullta ligjore.

### *III. B. Meritat e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë*

*Shkelja e pohuar e dispozitave të procedurës penale sipas Nenit 403, par. 1, pikës 10 të KPPK-së dhe shkeljet e tjera të pohuara*

Kërkesa e të pandehurit e mbështetur nga Prokurori i Shtetit duhet të refuzohet si e pabazuar (Neni 456, par. 1 i KPPK-së). Në kundërshtim me mendimin e tyre, aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi mbi ankesën nuk shkelin Nenin 403, par. 1, pikën 10 të KPPK-së. Gjykatat me të drejtë nuk kanë mbështetur vendimin e tyre në aktakuzën e ndryshuar ngase kanë konsideruar se rrethana e pohuar lehtësuese nuk ishte vërtetuar. Ato kanë zbatuar me të drejtë Nenin 386, par. 2 të KPPK-së duke konstatuar se gjykata nuk u detyrohet propozimeve të prokurorit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës. Kjo gjë do të thotë se gjykata – dhe jo prokurori – kanë lirinë e zgjedhjes së përgjegjshme të vlerësimit nëse janë konstatuar rrethanat lehtësuese apo ato vështirësuese. Kjo gjë vlen sidomos në rastet kur përshkrimi i veprës dhe cilësimi juridik i përmendur në aktakuzë nuk përputhen me njëri tjetrin. Trupi gjyqësor duhet të pasqyrojë përshkrimin faktik në mënyrën më të saktë.<sup>2</sup> Kjo gjë është bërë në mënyrë të rregullt.

Të drejtat e të pandehurit sa i përket ndryshimit të cilësimit juridik që shpie në dëmtimin e mundshëm të tij janë respektuar gjatë procedurës së shkallës së parë dhe të dytë. Një respekt i tillë tashmë është kërkuar nga jurisprudenca sipas legjislacionit të.<sup>3</sup> Por kjo gjë vlen edhe për trajtimin e të pandehurit në përputhje me ligjin e tanishëm në fuqi. I akuzuari ka të drejtë të informohet lidhur me akuzat ndaj tij / saj dhe të ketë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet. Edhe pse këto të drejta të garantuara nuk përcaktohen qartë me Nenin 386 të KPPK-së, të njëjtat bëhen të qarta nga disa dispozita të këtij Kodi (p.sh. Neni 12 etj.) Për më tepër, këto të drejta janë të përcaktuara me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut<sup>4</sup> dhe të përmendura në Nenin 30 të

<sup>2</sup> Shih mes tjerash Nenin 346, par. 2 të Ligjit mbi procedurën penale, Gazeta zyrtare nr. 26/86; shih po ashtu Komentimin e dytë mbi Ligjin e procedurës penale të OSBE-së, Departamenti i demokratizimit, Sarajevë 1999, me autorët Dr. Hajrija Sjercic-Colic, Drasko Vuleta dhe Malik Hadziomeragic.

<sup>3</sup> Neni 346, par 2 i Ligjit të procedurës penale, Gazeta zyrtare, nr. 26/86; shih po ashtu Komentimin e parë mbi Ligjin e procedurës penale nga autori Branko Petric, 1986, botimi i dytë, Gazeta zyrtare e RSFJ-së, Beograd, Pjesa IV, paragrafët 1 dhe 4.

<sup>4</sup> Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, e datës 4 nëntor 1950



Kushtetutës së Kosovës. Domosdoshmëria e garancive procedurale në rast të ndryshimit të emërimit ligjor është vërtetuar nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Në lëndën Pelissier dhe Sassi kundër shtetit të Francës, GjEDNj ka konstatuar se “Neni 6 § 3 (a) i Konventës ia njuh të pandehurit të drejtën për t’u informuar jo vetëm për shkakun e akuzimit të tij, d.m.th. duke i përmendur veprat të cilat pohohet se janë kryer nga i pandehuri dhe mbi të cilat bazohet aktakuza, por gjithashtu edhe cilësimin ligjor të këtyre veprave.”<sup>5</sup> GjEDNj konsideron se të drejtat e të pandehurit nuk shkelen gjatë vlerësimit të faktit nëse procedura në tërësi ka qenë e drejtë apo jo (duke përfshirë këtu edhe fazën ankimore dhe shqyrtimin e bërë gjatë kësaj faze). I akuzuari ka pasur rastin ta njoftojë mbrojtjen e vet lidhur me emërtimin e ndryshuar juridik.<sup>6</sup>

I pandehuri nuk ka qenë i befasuar nga vendimet e gjykatave komunale dhe të qarkut të cilat kanë vepruar në mënyrë transparente dhe të parashikueshme.

Gjykata Supreme vëren se kolegji i gjykatës komunale ka vlerësuar nëse kushtet e mbrojtjes së domosdoshme sipas Nenit 8 të KPK-së dhe heqja e dënimit sipas Nenit 317, par. 4 të KPK-së janë përmbushur në këtë rast apo jo, dhe ka konstatuar se nuk janë plotësuar këto kushte.

I pandehuri pastaj është dënuar sipas Nenit 317, par. 2, lidhur me par. 1 të KPK-së. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë ka bërë një ndryshim të vogël në cilësimin juridik të përcaktuar me Nenin 386, par. 2 të KPPK-së. Trupi gjykues ka shqyrtuar ndryshimin e cilësimit i cili, në pikëpamjen e tyre, ka vënë në pikëpyetje përshkrimin faktik, por ka ruajtur *identitetin* e fakteve në aktakuzë dhe në aktgjykim.


Për më tepër, Tomë Gashi, fillimisht është akuzuar për veprën penale e përmendur sipas Nenit 317, par. 2, në kuptim me par. 1 të KPK-së dhe prandaj ka deklaruar rastin e vet sipas këtij cilësimi juridik, derisa Prokurori ka ndryshuar aktakuzën gjatë seancës së fundit gjyqësore. Kur është shpallur aktgjykimi, i pandehuri është informuar për ndryshimin e cilësimit juridik dhe ka pasur mundësinë që të dorëzojë pretendimin e vet lidhur me këtë gjatë procedurës ankimore. Ai po ashtu ka shpjeguar këtë arsye të ankesës gjatë seancës ankimore më 7 dhjetor 2010.<sup>7</sup>

Në fund, nuk ka pasur shkelje të Nenit 3 të KPPK-së, pasi që nuk ka dyshim në këtë lëndë përkitazi me ekzistencën e fakteve të rëndësishme të cilat lidhen me lëndën ose me zbatimin e dispozitave të caktuara të procedurës penale.

<sup>5</sup> Lënda e GjEDNj-së Pelissier dhe Sassi kundër shtetit francez, Kërkesa nr. 25444/94, aktgjykimi i datës 25 mars 1999, par. 51, al fine; shih gjithashtu par. 62. “Gjykata në pajtim me këtë konsideron se gjatë shfrytëzimit të kësaj së drejte e cila pa dyshim se do të rritheksonte faktet mbi të cilat do të kishte në drejtë kompetenca, Gjykata e Apelit në Aix-en-Provence është dashur t’u ofronte parashtruesve mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre të mbrojtjes lidhur me atë çështje në mënyrë praktike dhe efektive dhe në veçanti, brenda afatit kohor. [...]”; shih po ashtu lëndën e GjEDNj-së Aldoshkina kundër shtetit rus, Kërkesa nr. 66041/01, aktgjykimi i datës 12 janar 2007, paragrafët 23-25.

<sup>6</sup> shih po ashtu lëndën e GjEDNj-së Dallos kundër shtetit hungarez, Kërkesa Ap nr. 29082/95, aktgjykimi i datës 1 mars 2001, paragrafi 52.

<sup>7</sup> Shih Ankesën P nr. 514/09 e të pandehurit Tomë Gashi, 30 shtator 2010, faqe 1; Aktgjykimin AP Nr. 395/10 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, 9 dhjetor 2010, faqe 3



Të drejtat e mbrojtjes janë respektuar plotësisht gjatë procedurës penale kundër Tomë Gashi, në veçanti në kohën e ndryshimit të përcaktimit ligjor, dhe nuk është bërë asnjë shkelje e dispozitave të procedurës penale nga gjykatat e shkallës së parë dhe/ose të dytë.

*Shkelje e pretenduar e dispozitave të procedurës penale nën nenin 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK*

Aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë prekur nga dështimet procedurale të tjera të theksuara nga i pandehuri.

Ndryshe nga mendimi i të pandehurit, dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë nuk është i pakuptueshëm dhe kontradiktore me arsyet e aktgjyimit.

Dispozitiv përmban të dhënat e nevojshme siç kërkohet nga neni 396 i KPPK, sidomos vendimi me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, përshkrimin e veprës për të cilën ai ishte shpallur fajtor dhe një deklaratë mbi dënimin. Gjykata Komunale vazhdoi në një vlerësim të detajuar të gjendjes faktike dhe shqyrtoi versione të ndryshme të renditjes së ngjarjeve. Aktgjykimi përmban gjetjet e trupit gjykues, si dhe arsyet e dënimit. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka përpunuar në mënyrë të qartë mbi lëndimet e palës së dëmtuar si pasojë e veprimit të të pandehurit në dispozitiv, ndryshe nga seç pretendon avokati mbrojtës.<sup>8</sup>

Argumenti i mbrojtës se trupi gjykues i Gjykatës Komunale kishte shpikur një hotel-bar 'Route 66' nuk mbështetet nga asnjë shpjegim dhe për këtë arsye është refuzuar. Nga ana tjetër, pranueshmëria e deklaratave të dëshmitarëve nga gjykata e shkallës së parë dhe përputhshmëria e tyre me nenin 156 paragrafi 2 të KPPK, tashmë dorëzuar kolegjit të apelit, nuk bien nën fushëveprimin e nenit 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK.


*Shkelje e pretenduar e dispozitave të procedurës penale nën nenin 403 paragrafi 2 pikat 1 dhe 2 të KPPK*

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës për të mbrojtur lëndën e tij, i pandehuri nuk ka dhënë ndonjë shpjegim të arsyeshëm. Asnjë vërejtje nuk është dhënë në këtë pretendim nga ana e ZPSK.

Gjykata Supreme vëren se i akuzuari gjerësisht ishte shprehur gjatë seancave gjyqësore në procedurën penale P. 514/09. Kryetari i kolegjit i ka lejuar të mbroj lëndën e tij dhe u përpoq vetëm të kufizoj komentet e të pandehurit dhe mocionet në ato thelbësore lidhur me lëndën në fjalë.<sup>9</sup>

<sup>8</sup> Shih aktgjykimin P. Nr. 514/09 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, 28 maj 2010, faqja 2: "dhe i pandehuri Tome i ka rezistuar prangosjes duke mbërthyer dhe shtyrë oficerët me duar, dhe gjatë këtyre veprimeve ata ranë në tokë, si rezultat i të cilit personi i lartpërmendur i lënduar ka pësuar lëndime të tilla si hematoma në krahun e majtë, shtypje në kokë dhe gjurin e majtë, të kualifikuar si lëndime të lehta trupore duke rezultuar në një dëmtim të përkohshëm të shëndetit;" - theksim i shtuar -

<sup>9</sup> Shih *inter alia* Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor P. Nr. 514/09 i Gjykatës Komunale të Prishtinës, 27 maj 2010, faqe 4




Sa i përket asaj se Kryetari i kolegjit refuzoi të pandehurin për të bërë një pyetje shtesë për dëshmitarët, ai vetëm ushtroi të drejtën e tij për të udhëhequr procedurën penale të parapara me nenin 332 dhe në respektimin e KPPK, pa penguar të pandehurin për të ushtruar të drejtat e tij. Tomë Gashi gjatë vazhdoi me ri-marrjen në pyetje të palës së dëmtuar dhe e ballafaqoi atë me deklaratën e tij të mëparshme. Ai kishte mundësin për të ri-intervistuar tre oficerë të tjerë të policisë dhe një dëshmitar tjetër . Tomë Gashi dhe të pandehurit e tjerë dhanë pëlqimin që deklaratat e dëshmitarëve të tjera të konsiderohen të lexuara në gjykatë.<sup>10</sup> Kjo procedurë është në përputhje të plotë me nenin 165 paragrafi 1 i KPPK sipas të cilave “secilës palë duhet ti jepet mundësia për të marrë në pyetje dëshmitarin i cili është marrë në pyetje nga pala tjetër”. Të dy gjykatat i aprovuan të pandehurit një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshem.

### *Shkelje e pretenduar e ligjit penal*

I pandehuri pretendon se është bërë shkelje e ligjit penal për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike. Ky parashtrim nuk është komentuar nga ZPSK. Kolegji i Gjykatës Supreme vëren se vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike tanimë ishte ngritur në fazën e ankesës nga i pandehuri. Gjykata e shkallës së dytë ka shqyrtuar këtë pikë dhe e ka refuzuar atë si të pabazuar. Por, edhe mos të kishte ndodhur, kjo nuk do të mund të justifikonte kërkesën e tanishme. Neni 451 paragrafi 2 i KPPK parashikon që Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk mund të paraqitet në bazë të vërtetimit të gabueshem ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.



<sup>10</sup> Shih Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor P. Nr. 514/09 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, 14 maj 2010, faqet 9-13; dhe faqe 16 dhe fol.; 27 maj 2010, faqet 2-3.